

NË EMËR TË POPULLIT
GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT

[Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prerë dhe mund të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm]

Rasti: P. 372/13

Data: 21 prill 2016

Gjykata themelore e Prizrenit me trupin gjykues të përbërë nga kryetari i trupit gjykues gjyqtari i EULEX-it Piotr Bojarczuk dhe anëtarët e trupit gjykues gjyqtari i EULEX-it Jorge Martins Ribeiro dhe gjyqtari Artan Sejrani dhe procesmbajtësja Venera Hadri-Mollakuqe në rastin penal kundër:

E.K.,

D.K.,

B.K.,

A.K.,

H.K..

Të akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar PPS nr. 1/2011 të datës 28 qershor 2011 të ngritur në Gjykatën Themelore të Prizrenit dhe të lëshuar më 5 shkurt 2014, për veprat penale të përshkruara në aktakuzës si vijon;

E.K. dhe D.K. të akuzuar për:

AKUZA 1: Vrasje e rëndë, ndesh me nenin 147 paragrafi 9 në lidhje me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), i dënueshëm me së paku dhjetë vjetër burgim afatgjatë.

B.K. dhe E.K. të akuzuar për:

AKUZA 2: Lëndim i rëndë trupor, ndesh me nenin 154 paragrafi 2, nënparagrafi 4 në lidhje me paragrafin 1, nënparagrafi 2, në lidhje me nenin 23 të KPPK, i dënueshëm me 6 muaj deri në dhjetë vjet burgim.

B.K. i akuzuar për:

AKUZA 3: Lëndim i rëndë trupor, ndesh me nenin 154 paragrafi 1, nënparagrafi 3 të KPPK, i dënueshëm me 6 muaj deri në pesë vjet burgim.

A.K. dhe H.K. të akuzuar për:

AKUZA 4: Ndihma në vrasje të rëndë, ndesh me nenin 147 paragrafi 1, nënparagrafi 9 në lidhje me nenet 25 dhe 65, paragrafi 2 të KPPK, i dënueshëm me burgim jo më shumë se tre të katërtat e dënimit maksimal të paraparë për veprën penale.

D.K. dhe B.K. të akuzuar për:

AKUZA 5: Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, ndesh me nenin 328 paragrafi 2 të KPPK i dënueshëm me gjobë deri në 7,500 euro ose me një deri në tetë vjet burgim.

Pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore në praninë e prokurorit Blerim Isufaj, më vonë e zëvendëson prokurori Elez Blakaj, të akuzuarit dhe avokatët e tyre mbrojtës Florin Vertopi, Shemsedin Piraj, Durmish Koçinaj, Rexhep Hasani, Myrvete Qollaku dhe Florije Drevinja, palët e lënduara Azem, Ilir dhe Minire Limaj, të përfaqësuar nga avokati mbrojtës Ethem Rugova, më vonë e zëvendëson Qazim Xharra;

Në datat vijuese:

2014:

27 janar, 5 dhe 6 shkurt, 4, 11, 13, 18, dhe 20 mars, 24 dhe 25 prill, 15 dhe 16 maj, 3, 7, 21 dhe 22 korrik, 4 dhe 22 shtator, 1, 20, 27 dhe 30 tetor, 11 dhe 20 nëntor.

2015:

6, 8, 9, 13 dhe 14 janar, 11, 12 dhe 27 shkurt, 24 prill, 8 korrik, 20 gusht, 3 shtator, 26 tetor, 25 nëntor.

2016:

25, 27, 28 dhe 29 janar, 1, 2 dhe 29 shkurt, 1 dhe 22 mars, 21 prill.

pas seancës së vendimmarrjes dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 21 prill 2016:

NË BAZË TË neneve 385, 387, 388, 390, 391 dhe 392 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), sot më 21 prill 2016, trupi gjykues në shqyrtimin publik dhe në praninë e të pandehurve, avokatëve mbrojtës dhe prokurorit, e nxjerrë këtë:

* * *

AKTGJYKIM

Për AKUZËN 1, i pandehuri **E.K.** shpallet

FAJTOR

Sepse: Më 1 janar 2011 rreth orës 19:30, në fshatin Banjë, komuna e Malishevës, në restorantin “Kështjella”, pasi që i pandehuri dhe të bashkë-pandehurit u pajtuan dhe planifikuan të hakmerreshin dhe t’i shkaktonin dëm familjes L. në restorantin “Oda” në Malishevë pasdite, shkak i një grindjeje që kishte ndodhur mes B.L. dhe H.K.t më 12 dhjetor 2010 gjatë zgjedhjeve parlamentare, i pandehuri bashkë me së paku bashkë të pandehurit **D.K**, **B.K.** dhe **H.K.**, me së paku dy automjete, një Audi 6, pronë e bashkë të pandehurit **H.K.** dhe një Volkswagen Pasat. pronë e G.K., shkuan në drejtim të restorantit “Kështjella” pronë e familjes L. Bashkëkryerësi **A.K.** e kishte informuar të pandehurin për praninë e anëtarëve të familjes L. atje. Pas parkimit të veturave të tyre, i pandehuri i armatosur me një shufër metalike, bashkë me bashkë të pandehurit **D.K.** dhe **B.K.** të armatosur me pushka automatike, hyrën në hapësirat e restorantit. Derisa i pandehuri dhe bashkë të pandehurit bërtisnin dhe shanin, thërrisnin “ku jeni, bijtë e Gjokës?”, i pandehuri iu afrua tavolinës ku S.L. Ulaj rrinte ulur dhe shikonte TV, i rrethuar nga familja dhe fëmijët e tjerë. Me qëllim për ta privuar nga jeta S.L., ai e goditi atë disa herë me shufër metalike, përfshirë në kokë dhe krah. Kjo goditje i shkaktoi lëndime fatale që rezultoi me shembje dhe gjakderdhje nën membranat e buta të trurit. Edhe pse për një periudhë të shkurtë, S.L. përjetoi dhembje të jashtëzakonshme fizike, prandaj i pandehuri duke goditur S.L. me shufër metalike veproi pamëshirshëm dhe dhunshëm.

- Prandaj e kreu veprën penale vrasje e rëndë, ndesh me nenin 147 paragrafët 5 dhe 9 të KPPK. (Kështu bëhet ri-cilësimi i akuzës së parë vrasje e rëndë, ndesh me nenin 147 paragrafi 9 në lidhje me nenin 23 të KPPK).

Për AKUZËN 1, i pandehuri **D.K.**,

Në bazë të nenit 390, paragrafi 3 i KPPK,

LIROHET nga akuza.

Sepse: nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën është akuzuar në aktakuzë, përkatësisht për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë, ndesh me nenin 147 paragrafi 9 në lidhje me nenin 23 të KPPK).

Për AKUZËN 2, i pandehuri B.K. shpallet

FAJTOR

Sepse: Më 1 janar 2011 rreth orës 19:30, në fshatin Banjë, komuna e Malishevës, në restorantin “Kështjella”, i pandehuri B.K., i armatosur me armë zjarri të tipit AK 47, me qëllim të shkaktimin të lëndimeve trupore, ka shtënë një herë në drejtim të palës së lënduar A.L. dhe e ka qëlluar në gjurin e djathtë, duke i shkaktuar lëndime të cilat përgjithmonë ia dobësuan funksionin e muskulit të pulpës së këmbës të djathtë dhe pamundësinë e lakimit të shputës dhe përkohësisht dhe thellësisht e dobësuan aftësinë e A.L. për punë.

- Prandaj ai e kreu veprën penale lëndim i rëndë trupor ndesh me nenin 154 paragrafi 1, nënparagrafët 2 dhe 4 të KPPK. (Kështu bëhet ri-cilësimi i akuzës së parë lëndim i rëndë trupor ndesh me nenin 154 paragrafi 2, nënparagrafi 4 në lidhje me paragrafin 1, nënparagrafi 2, në lidhje me nenin 23 të KPPK).

Për AKUZËN 2, i pandehuri E.K.,

Në bazë të nenit 390, paragrafi 3 i KPPK,

LIROHET nga akuza

Sepse: nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën është akuzuar në aktakuzë, përkatësisht veprën penale lëndim i rëndë trupor ndesh me nenin 154, paragrafi 2, nënparagrafi 4 në lidhje me paragrafin 1, nënparagrafin 2, në lidhje me nenin 23 të KPPK.

Për AKUZËN 3, i pandehuri **B.K.**, shpallet

FAJTOR

Sepse: Më 1 janar 2011 rreth orës 19:30, në fshatin Banjë, komuna e Malishevës, në restorantin “Kështjella”, i pandehuri **B.K.**, i armatosur me armë zjarri të tipit AK 47, me qëllim të shkaktimeve të lëndimeve trupore, ka shtënë në pjesën e poshtme të trupit të palës së dëmtuar I.L. Edhe pse i pandehuri dështoi ta qëllonte palën e dëmtuar, grimcat e plumbit ,pasi që ai e qëlloi tokën, e qëlluan palën e dëmtuar I.L. në nyjat e të dy shputave. Këto lëndime përkohësisht e bën të pafte për punë palën e dëmtuar.

- Prandaj ai e kreu veprën penale lëndim i rëndë trupor ndesh me nenin 154 paragrafi 1, nënparagrafi 4 të KPPK. (Kështu bëhet ri-cilësimi i akuzës së parë lëndim i rëndë trupor ndesh me nenin 154 paragrafi 1, nënparagrafi 3 të KPPK).

Për AKUZËN 4, i pandehuri **H.K.** shpallet

FAJTOR

Sepse: Më 1 janar 2011 rreth orës 19:30, në fshatin Banjë, komuna e Malishevës, në restorantin “Kështjella”, ai qëllimisht i ndihmoi bashkë të pandehurit **E.K.** në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë duke marrë pjesë në takim me bashkë të pandehurin në restorantin “Oda” dhe në planifikimin e shkuarjes në restorantin “Kështjella” për t’u shkaktuar dëme familjes L., dhe duke e shoqëruar bashkë të pandehurin **E.K.** larg nga vend-krimi, me automjetin e tij Audi A6.

- Prandaj ai e kreu veprën penale ndihma në vrasje të rëndë, ndesh me nenin 147 paragrafi 1, nënparagrafi 9 në lidhje me nenin 25 të KPPK

Për AKUZËN 4, i pandehuri A.K.,

ndesh me nenin 390, paragrafi 3 i KPPK,

LIROHET nga akuza

Sepse: nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën është akuzuar në aktakuzë, përkatësisht veprën penale ndihma në vrasje të rëndë, ndesh me nenin 147 paragrafi 1, nënparagrafi 9 në lidhje me nenet 25 dhe 27, paragrafi 1, të KPPK.

Për AKUZËN 5, i pandehuri D.K. shpallet

FAJTOR

Sepse: i pandehuri **D.K.** nga një datë e pacaktuar deri më 2 janar 2011 në komunën e Malishevës, ka qenë në mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armës së zjarri të tipit AK 47 kalibri 7.62 x 39mm, me numër serik 074949-89.

- Prandaj, i pandehuri **D.K.** e ka kryer veprën penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, ndesh me nenin 374, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK) (përpara: neni 328 paragrafi 2 i KPPK).

Për AKUZËN 5, i pandehuri B.K. shpallet

FAJTOR

Sepse: i pandehuri **B.K.** nga një datë e pacaktuar deri më 2 janar 2011 në komunën e Malishevës, ka qenë në mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të

paautorizuar të armës së zjarri të tipit AK 47 kalibri 7.62 x 39mm, me numër serik 759933, me çka më 1 janar 2011 i ka kryer dy vepra penale të lëndimit të rëndë trupor me këtë armë.

- Prandaj, i pandehuri **B.K.** e ka kryer veprën penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, ndesh me nenin 328, paragrafët 1 dhe 2 të KPPK.

* * *

PRANDAJ i pandehuri **E.K.**

DËNOHET

Për AKUZËN 1, në bazë të nenit 147, paragrafët 5 dhe 9 të KPPK, në lidhje me nenet 37 dhe 73 të KPPK; me *burgim afatgjatë në kohëzgjatje prej 22 (njëzet e dy) vitesh.*

Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet prej datës 2 janar 2011 deri atëherë kur aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm në bazë të nenit 391 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 i KPPK dhe nenit 73 të KPPK.

I pandehuri **B.K.**

DËNOHET

Për AKUZËN 2, Në bazë të nenit 154, paragrafi 1 të KPPK, në lidhje me nenet 38 dhe 73 të KPPK, *me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh dhe 10 (dhjetë) muajsh.*

Për AKUZËN 3, Në bazë të nenit 154, paragrafi 1 të KPPK, në lidhje me nenet 38 dhe 73 të KPPK, *me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh dhe 9 (nëntë) muajsh.*

Për AKUZËN 5, në bazë të nenit 374, paragrafi 1 të KPPK, në lidhje me nenet 38 dhe 73 të KPPK, *me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.*

Në bazë të nenit 71 të paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2 i KPPK, , i pandehuri **B.K.** dënohet me dënim unik *me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vitesh.*

Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet nga data 2 janar 2011 deri më 10 nëntor 2015 dhe masa e arrestit shtëpiak prej datës 10 nëntor 2015 deri atëherë kur aktgjykimi ë bëhet i plotfuqishëm në bazë të nenit 391 paragrafi 1 nënparagrafi 5 i KPPK dhe nenit 73 të KPPK.

I pandehuri **H.K.**,

DËNOHET

Në bazë të nenit 147, paragrafi 1, nën-paragrafi 9, në lidhje me nenet 25, 37, 65, paragrafi 2, dhe 73 të KPPK;

Për AKUZËN 4,

Me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjet.

Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet nga data 2 janar 2011 deri më 7 qershor 2012 dhe masa e arrestit shtëpiak prej datës 7 qershor 2012 deri më 10 gusht 2012 në bazë të nenit 391 paragrafi 1 nënparagrafi 5 i KPPPK dhe nenit 73 të KPPK.

I pandehuri **D.K.**,

DËNOHET

Në bazë të nenit 374, paragrafi 1 të KPK, në lidhje me nenet 38 dhe 73 të KPPK;

Për AKUZËN 5:

Me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit.

Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet nga data 2 janar 2011 deri më 7 qershor 2012 dhe masa e arrestit shtëpiak prej datës 7 qershor 2012 deri më 10 gusht 2012 në bazë të nenit 391 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 i KPPPK dhe nenit 73 të KPPK.

* * *

Në bazë të nenit 60, në lidhje me nenin 54 paragrafi 2 nënparagrafi 7 i KPPK, gjykata e shqipton dënimin plotësues të:

KONFISKIMIT TË GJËSENDEVE

Në bazë të nenit 328, paragrafi 5 i KPPK, arma e sekuestruar AK 47 e kalibrit 7.62 x 39 mm, me numrin serik 074949-89, konfiskohet.

Në bazë të nenit 328, paragrafi 5 i KPPK, arma e sekuestruar AK 47 e kalibrit 7.62 x 39 mm, me numrin serik 759933, konfiskohet.

Në bazë të nenit 54 paragrafi 2 nënparagrafi z, automjeti Audi 6 me numër regjistrimi 610-KS-898 5, pronë **H.K.**, konfiskohet ngase është përdorur në kryerjen e veprave penale të lartpërmendura.

Automjete e tjera të sekuestruara do t'u kthehen pronarëve legjitim.

* * *

SHPENZIMET PROCEDURALE

Në bazë të nenit 102 të KPPK, të pandehurit të cilët janë shpallur fajtor do të jenë bashkërisht dhe veçmas përgjegjës për pagesën e këtyre shpenzimeve procedurale.

I pandehuri **D.K.** do të paguajë shumën prej € 300, - (treqind euro), i pandehuri **H.K.** do të paguajë shumën prej € 500, -(pesëqind euro), i pandehuri B.K. do të paguajë shumën prej € 800, -(tetëqind euro), i pandehuri **E.K.** do të paguajë shumën prej € 1500, -(njëmijë e pesëqind euro).

* * *

KËRKESA PRONËSORE – JURIDIKE

Pala e dëmtuar mund të parashtrojë kërkesë për kompensim përmes gjykatave civile.

* * *

A R S Y E T I M

I. Historia procedurale

Aktakuza dhe rigjykimi

1. Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren ka nxjerr Aktvendimin për fillimin e hetimeve me numër Hp. 1/2011 e datës 3 janar 2011 kundër të pandehurve Emin Krasniqi, Sulejman Krasniqi, Mehedin Krasniqi, Hazir Krasniqi, Dardan Krasniqi, Shkumbim Krasniqi, Rame Krasniqi, Andi Krasniqi, Ilaz Krasniqi, Berat Krasniqi, Durim Krasniqi, Ilir Bytyqi dhe Astrit Krasniqi. Më 5 janar 2011, u nxor Aktvendimi me numër të njëjtë për zgjerimin e hetimeve kundër të pandehurit Shpejtim Zogaj.
2. Më vonë, rasti i transferua në Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) e cila parashtroi Aktakuzën e Ndryshuar PPS nr. 1/2011 e datës 28 qershor 2011 dhe ia paraqiti Gjykatës Themelore në Prizren, dhe e ri-nxori atë më 5 shkurt 2014.
3. Më 3 janar 2011 Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut në Prizren urdhëroi paraburgimin kundër të gjithë të pandehurve. Më vonë paraburgimi u vazhdua për të pandehurit Emin Krasniqi dhe Berat Krasniqi kohë pas kohe deri në shqiptimin e dënimit pas përfundimit të gjykimit. Më 6 qershor 2012 trupi gjykues ndërpreu paraburgimin kundër Astrit Krasniqit dhe Hazir Krasniqit dhe e zëvendësoi atë me arrest shtëpiak. Paraburgimi kundër të pandehurit Durim Krasniqit u ndërpre më 10 gusht 2012 kurse arresti shtëpiak kundër Astrit Krasniqit dhe Hazir Krasniqit u ndërpre të njëjtën ditë përmes një aktvendimi të veçantë.
4. Më 21 mars 2011, rasti kundër Andi dhe Mehedin Krasniqit u veçua nga rasti aktual.¹
5. Shqyrtimi gjyqësor u mbajt para ish Gjykatës së Qarkut në Prizren në pjesën e parë të vitit 2012. Trupi gjykues, në përbërje të dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari vendor, nxori

¹ Procesverbali i gjykimit të parë, 21.03.2011, faqe 9.

Aktgjykimin më 10 gusht 2012, me të cilin i pandehuri Emin Krasniqi u gjet fajtor për Pikat 1 dhe 2, i pandehuri Berat Krasniqi u gjet fajtor për Pikat 1, 2 dhe 5, i pandehuri Durim Krasniqi u gjet fajtor për Pikën 5 dhe u lirua nga akuza për Pikën 1 dhe të pandehurit Hazir dhe Astrit Krasniqi u gjetën fajtor për Pikën 4. Emin Krasniqi u dënua me burgim në kohëzgjatje prej njëzet e tre (23) vjet, Berat Krasniqi u dënua me burgim unik prej shtatë (7) vjet dhe pesë (5) muaj, Durim Krasniqi u dënua me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vjet dhe Hazir dhe Astrit Krasniqi, që të dy, u dënuan me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjet.

6. Të pandehurit parashtruan ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut dhe me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në lëndën me numër PAKR.nr. 275/13, i cili u nxor më 14 tetor 2013, Gjykata e Apelit e anuloi vendimin e Gjykatës së Qarkut kundër të gjithë pesë të pandehurve dhe vendosi që lënda t'i kthehet, tani, Gjykatës Themelore në Prizren për rigjykim.
7. Me të njëjtin Aktvendim të datës 14 tetor 2013, Gjykata e Apelit urdhëroi që të vazhdohet paraburgimi kundër të akuzuarve Emin Krasniqi dhe Berat Krasniqi.
8. Pastaj lënda u kthye në Gjykatën Themelore në Prizren për rigjykim dhe gjyqtari këtu u caktua si kryetar i trupit gjykues (në tekstin e mëtejshëm: trupi gjykues). Përbërja e trupit gjykues nuk është kontestuar nga asnjëra palë. Prandaj, supozohet se ata kanë hequr dorë nga e drejta e tyre që ta kontestojnë përbërjen.
9. Në rastin kur parashtrohet një ankesë në favor të të akuzuarit, atëherë Aktgjykimi nuk mund të ndryshohet në dëm të tij në lidhje me klasifikimin ligjor dhe sanksionit penal. Sidoqoftë, të gjitha palët e këtij rasti kanë parashtruar ankesë, prandaj trupi gjykues nuk kufizohet në Aktgjykimin e mëhershëm.
10. Më 27 janar 2014, lënda rifilloi. Me këtë datë trupi gjykues mori aktvendim fillestar se provat në këtë rast do të regjistrohen me zë dhe me video në pajtim me nenin 348, paragrafët 2 deri 4 të

Kodit të Pakohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme referohet si “KPPPK”)²

11. Gjykimi fillimisht u mbajt në seanca publike. Palët e dëmtuara Minire Limaj, Ilir Limaj dhe Azem Limaj, me kërkesën e tyre, u dëgjuan në seanca të mbyllura më 5 dhe 6 shkurt dhe 4, 11 dhe 13 mars 2014.³

Pranueshmëria e provave

12. Më 12 gusht 2011, Aktakuza e parashtruar nga PSRK u konfirmua nga, në atë kohë, Gjykata e Qarkut në Prizren.⁴ Gjykata vendosi që të gjitha provat në shkresat e lëndës ishin të pranueshme.

13. Florin Vertopi, avokati mbrojtës i Emin Krasniqit, parashtroi një propozim më datën 27 janar 2014. Ai kërkoi që të deklaroheshin të papranueshme provat si në vijim: - deklarata e të bashkë pandehurit Astrit Krasniqi dhënë policisë më datën 2 janar 2011 – raportet e Tefik Gashit dhe Hazir Kelmendit - raportet e kryerjes së vendit të ngjarjes të datës 1 janar 2011 dhe 19 janar 2011 dhe raport i rikonstruktimit (rindërtimit) kryer më datën 5 qershor 2012. Me aktvendimin e datës 5 shkurt 2014, i poshtë nënshkruari kryetari i trupit gjykues vendosi që deklarata e lartshënuar e Astrit Krasniqit është e papranueshme dhe është veçuar nga shkresat e lëndës dhe nga konsiderata e gjykatës sepse ishte marrë në shkelje të nenit 73 të KPPPK. Kryetari i trupit gjykues vendosi që provat tjera janë të pranueshme.

14. Më tutje, gjykata mori një aktvendim tjetër rreth pranueshmërisë së ekspertizës nga Tefik Gashi me aktvendimin e saj të datës 25 janar 2016, ku deklarohet se ekspertiza e Tefik Gashit është provë e pranueshme, posaçërisht në çështjen e shkakut të vdekjes së Skender Limaj.

² Megjithatë trupi gjykues u informua nga stafi teknik i Gjykatës Themelore të Prizrenit se për shkak të problemeve të pazgjdhura teknike regjistrimi me zë dhe me video për të gjitha seancat e mbajtura pas datës 25.11.15 kishin dështuar.

³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 05.02.2014, faqet 5 dhe 6.

⁴ Aktvendimi për konfirmim, Gjykata e Qarkut në Prizren, Ka.nr. 133/2011, regjistratori 8, ndarja 9.

15. Më 21 prill 2016, Florin Vertopi, avokati mbrojtës i Emin Krasniqi, kërkoi rihapjen e procedurës penale në mënyrë që të administrohen si prova 5 fotografi të restorant ‘Keshtjellës’ para ndodhjes së incidentit. Trupi gjykues e refuzoi këtë kërkesë sepse burimi i fotografive ishte i paqartë dhe se restoranti (vendi i ngjarjes) tashmë ishte fotografuar disa herë. Këto fotografi janë pjesë e shkresave të lëndës. Përfundimisht, trupi gjykues vendosi se ishte e paqartë pse mbrojtja i dorëzoi këto fotografi kaq vonë në procedurë.⁵

16. Mbledhja përfundimtare e materialit provues përbëhet nga provat materiale të shkruara në Aneks 1 dhe përmbajtja e regjistratorëve të shkresave të lëndës të shkruara në Aneks 3. Më tutje, dëshmitarët dhe dëshmitarët ekspert në vijim janë dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor (shiko Aneks 2):

Minire Limaj	5 shkurt 2014
Ilir Limaj	6 shkurt dhe 4 mars 2014
Azem Limaj	11 dhe 13 mars 2014
Veli Limaj	18 mars 2014
Riza Berisha	20 mars 2014
Avni Krasniqi	24 prill 2014
Rexhep Morina	24 prill 2014
Haxhi Hazrolli	25 prill 2014
Alush Hazrolli	15 maj 2014
Mustafe Limaj	16 maj 2014
Behlul Limaj	3, 7, 21 dhe 22 korrik 2014
Valon Shala	4 shtator 2014
Ismail Hazrolli	22 shtator 2014
Arben Shala	27 tetor 2014
Faton Morina	30 tetor 2014
Xhavit Kryeziu	11 nëntor 2014

⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21.04.2016, faqet 2-4.

Flamur Blakaj	20 nëntor 2014, 8 janar 2015, 3 shtator 2015 (vizitë në vendin e ngjarjes), 25 nëntor 2015
Tefik Gashi	8, 9, 13, 14 janar 2014, 27 shkurt 2015
Hazir Kelmendi	11 dhe 12 shkurt 2015, 3 shtator 2015 (vizitë në vendin e ngjarjes), 25 nëntor 2015
Marek Gasior	20 gusht 2015

17. Të pandehurit janë dëgjuar më 27, 28 dhe 29 janar 2016 dhe më 1 dhe 2 shkurt 2016. Trupi gjykues ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar të gjitha pikat të paraqitura nga mbrojtja dhe prokuroria gjatë shqyrtimit gjyqësor. Prokuroria ka paraqitur se të gjithë pesë të pandehurit duhet të dënohen për krimet me të cilat janë akuzuar. Të pandehurit, të përfaqësuar nga avokatët mbrojtës të tyre, janë deklaruar të pafajshëm për akuzat përpos për posedim dhe përdorim të paautorizuar të armëve nga Berat dhe Durim Krasniqi.⁶

Ligji i zbatueshëm

18. Gjykata vëren se dispozitat e nenit 544 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (“KPPK”), Ligji Penal nr. L04/123, i cili ka hyrë në fuqi më 01 janar 2013, dhe në veçanti neni 544 i KPPK, i cili shkruan si titull “ligji i zbatueshëm në rishqyrtim”: Nëse pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi paraqitet ankesë ose me mjet të jashtëzakonshëm juridik anulohet aktgjykimi, shqyrtimi gjyqësor zbatohet *mutatis mutandis* sipas dispozitave të kodit të mëparshëm”. Gjykata është e kënaqur se KPPK është ligji i zbatueshëm këtu përshtatëshmërisht.

II. Deklarimi i fakteve

19. Trupi gjykues ka shqyrtuar të gjitha provat të përfshira në Aneksë dhe në shkresat e lëndës. Në rastet kur një provë ka qenë në ndihmë të veçantë për trupin gjykues për të përcaktuar çështjet para tij, atëherë një gjë e tillë referohet në arsyetimin e poshtëm. Të gjitha referencat në lidhje me faqet-numrat kanë të bëjnë me versionin në gjuhën angleze të dokumentit.

⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 05.02.14.

20. Gjykata nxjerr faktet e mëposhtme nga shkresat e lëndës dhe procedurën gjatë shqyrtimit gjyqësor.
21. Të pandehurit Emin Krasniqi, Durim Krasniqi, Berat Krasniqi, Astrit Krasniqi dhe Hazir Krasniqi janë takuar më 1 janar 2011 në restorantin “Oda” në Malishevë rreth orës 15:00.⁷
22. Atë mbrëmje familja Limaj kishte një festë familjare në restorantin e tyre ‘Keshjtjella’ në Banjë, komuna e Malishevës. Fëmijët e familjes Limaj ishin në restorant, gjithashtu.⁸
23. Rizah Berisha, kamerier në restorantin Keshjtjella, e kishte filluar punën atë ditë në ora 15:30. Atje ishin edhe disa mysafirë, përfshirë Arben, Valon, Ilir dhe Afrim Shala. Rreth orës 19:00, një person, i cili më vonë ishte identifikuar si i pandehuri Astrit Krasniqi, ishte i ulur në mes të restorantit dhe hante pica.⁹ Astriti ishte parë të lëvizte shumë brenda dhe jashtë gjersa fliste në telefon.¹⁰ Ai kishte kontaktuar me të pandehurin Emin Krasniqi disa herë përmes telefonit celular.¹¹
24. Rreth orës 19:30, Emin, Berat dhe Durim Krasniqi arritën në restorant me së paku dy vetura, njëra prej të cilave ishte veturë Audi A6 me numër të regjistrimit që fillonte me 610-KS-, që i

⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 24.04.14, deklarata e Rexhep Morinës, pronar i restorantit Oda. Të gjithë të pandehurit, Emiri, Haziri, Durimi dhe Berati, kanë konfirmuar se ata kishin qenë në restorantin Oda para ngjarjes kritike. Ata, gjithashtu, kanë deklaruar se Astriti kishte ardhur që t’i merrte 10 euro nga Emiri.

⁸ Prania e fëmijëve ishte konfirmuar nga disa dëshmitarë. Shembuj, shiko procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 05.04.14, deklaratën e Ilir Limaj; procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 20.03.14, deklaratën e Rezi Berisha, faqe 12.

⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 16.05.14, deklarata e Mustaf Limaj, faqe 37; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, dëshmia e Ilir Limaj, faqe 31. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22.07.14, deklarata e Valon Shala, faqe 17.

¹⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 03.07.14, deklarata e Behlul Limaj, faqe 12. “Ai vazhdimisht lëvizte, jashtë, brenda, në telefon”; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 05.02.14, deklarata e Ilir Limaj. Astriti, gjithashtu, konfirmoi se kishte qenë në restorant.

¹¹ Prova materiale 25 (regjistratori i ndarë), Raporti i PTK për 45282353 pranimi i SMS – Emin Krasniqi.

përkiste Hazir Krasniqit.¹² Edhe pse mbetet e paqartë se si kishte shkuar në restorant Haziri, është vërtetuar se ai kishte hyrë në restorant, së paku për një kohë të shkurtë.¹³

25. Njëri prej mysafirëve, Valon Shala, i cili ishte jashtë, i kishte parë katër apo pesë persona duke hyrë në restorant.¹⁴ Pastaj ai kishte pranuar një telefonatë nga Arben Shala, i cili ishte ende në restorant dhe i cili i kishte thënë atij të mos kthehej brenda sepse kishte të shtëna.¹⁵ Gjersa Valon Shala ishte në parking, ai kishte vërejtur një veturë që e kishte të ndezur motorin.¹⁶
26. Emin, Berat, Durim dhe Hazir Krasniqi hynë në lokal përmes hyrjes kryesore të EV4, duke kaluar nga EV5 dhe hynë në hapësirën e EV6.¹⁷ Durim dhe Berat Krasniqi ishin të armatosur me pushkë automatike, gjersa Emini kishte një shufër metalike.¹⁸ Ata e përplasen derën dhe bërtitën dhe shanë duke bërtitur “ku jeni ju bijtë e Gjokës”.¹⁹ Ata filluan të shkrepin me armë pasi që hynë në restorant.²⁰
27. Skender Limaj ishte i ulur në pozicionin EV7, duke shikuar TV-në me fëmijët.²¹ I pandehuri Emin iu afrua tavolinës para TV-së.²² Skenderi e pa Eminin me shufër metalike, u mundua që të

¹² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 18.03.14, deklaratat e Veli Limaj. Veli Limaj kishte pa se Hazir Krasniqi ishte duke vozitur dhe duke u larguar me veturë nga restoranti menjëherë pasi që ngjarja ndodhi. Shiko paragrafin 31. Pronësia e veturës nuk është e kontestueshme.

¹³ Ai u pa nga disa dëshmitarë të ketë qenë i pranishëm në restorant gjatë ngjarjes kritike. Ka prova të pamjaftueshme për të vërtetuar se ai kishte ardhur së bashku me të pandehurit tjerë. Dëshmitarët kanë elaboruar sa përket pjesëmarrjes së Hazirit në sulm, por për shka se ai nuk është i akzuar për këto veprime me aktakuzë, gjykata përmbahet nga vlerësimi i këtyre deklaratave.

¹⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22.07.14, deklaratat e Valon Shala, faqe 21.

¹⁵ Po aty, faqe 22.

¹⁶ Po aty, faqe 28.

¹⁷ Prova materiale 13.1, skicat e restorant ‘Kështjella’. Emini dhe Hazir u njohën nga Ilir Limaj, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 05.02.14. Durimi u njoh nga Behlul Limaj, shiko procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 21.07.14. Më tutje, shiko procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, deklaratat e Azem Limaj, 13.03.14, faqet 16-17.

¹⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 13.03.14, deklaratat e Azem Limaj, faqe 10; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 03.07.14, deklaratat e Behlul Limaj, faqe 16; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 04.09.14, deklaratat e Valon Shala, faqe 15: “Emini kishte një shufër metalike”. Të dy, Durim dhe Berat Krasniqi e kanë pranuar se kanë poseduar dhe përdorur pushkë automatike, përkatësisht një armë zjarri e llojit AK 47 kalibri 7.62 x 39mm, me numër serik 074949-89 dhe një armë zjarri e llojit AK 47 kalibri 7.62 x 39mm, me numër serik 759933.

¹⁹ Minutes of the main trial, 16.04.14 statement of Mustafe Limaj, page 10; minutes of the main trial, 27.10.14, statement of Arben Shala, page 15; minutes of the main trial, 03.07.14, statement of Behlul Limaj, page 17: “Gjoka was a Serb who lived in Banje village. They said this to offend us”; minutes of the main trial 27.10.14, statement of Arben Shala, page 15.

²⁰ Minutes of the main trial, 16.05.14, statement of Mustaf Limaj, page 27.

²¹ Ibid

ngritej dhe e ngriti dorën që të mbrohej.²³ Me shufrën metalike, Emini e goditi dorën e Skenderit dhe pastaj e goditi atë në kokë.²⁴ Kjo goditje shkaktoi lëndime fatale, masive të indit të trurit dhe gjakderdhje nën cipën e butë të trurit duke i thyer eshtrat e kafkës.²⁵ Skenderi u rrëzua në dyshtemenë e drurit.²⁶ Ai u shtri në shpinë.²⁷

28. I pandehuri Durim Krasniqi, me armën e tij të zjarrit qëllloi nga pozicioni afër shtyllës 6 me këtë AK 47. Më vonë atë mbrëmje ishte gjetur një gëzhojë (EV11).²⁸

29. I pandehuri Berat Krasniqi qëllloi me armën e tij të zjarrit nga pozicioni afër EV10 në drejtim të lënduarit Ilir Limaj i cili ndodhej afër banakut.²⁹ Plumbi goditi dyshtemenë e shtruar prej gurit, duke kërcyer nga aty, qëllloi palën e dëmtuar, Ilirin, në këmbë, duke i shkaktuar plagë e cila i dëmtoi lëkurën, indet e lëkurës, ashtin e talusit të këmbës së djathtë, duke e thyer atë në shumë pjesë që depërtoi nëpër lëkurë dhe duke hyrë në pjesën e brendshme të këmbës së djathtë. Pjesa e

²² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 20.03.14, deklarata e Riza Berishës.

²³ Prova 1.4: Raporti nga Tefik Gashi dhe Flamur Blakaj; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 16.05.14, deklarata e Mustafë Limajt, faqe 11. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 14.01.15, deklarata e Tefik Gashit, faqe 38. Deklarata gjatë procedurës paraprake e Riza Berishës, faqe 3.

²⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27.01.16, faqe 13, deklarata e të pandehurit Emin Krasniqi: “Prokurori: Ju keni deklaruar si në vijim: Pas goditjes ai u rrëzua në dyshtemenë e atij restoranti. Ju vazhduat: “Kur u rrëzua ai, e di që shufra më ra nga dora, e mora shufrën dhe e godita një person tjetër i cili po vinte në drejtimin tim”. Ju sot deklaruat se ju nuk e keni përdorë atë shufër. Tani po iu parashtror pyetjen: a e keni përdorë atë shufër apo jo? Emin Krasniqi: kjo ishte me datën 14.01.2011, a është ashtu? Prokurori: Po. Emin Krasniqi: Kujtesa ime në atë kohë ishte më e freskët, kështu do të duhej të ishte rasti.”; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 03.07.14, deklarata e Behlul Limajt, faqe 18; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22.07.14, deklarata e Behlul Limajt, faqe 4; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 20.03.14, deklarata e Riza Berishës, faqe 41; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 04.03.14, deklarata e Ilir Limajt, faqe 6. Prova 1.2, raporti i autopsisë.

²⁵ Prova 1.2, Raporti i Autopsisë; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 20.11.14, 08.01.15, 09.01.15, 13.01.15, 14.01.15, 11.02.15, 12.02.15, 27.02.15, 20.08.15 – deklaratat e ekspertëve Flamur Blakaj, Tefik Gashi, Hazir Kelmendi dhe Marek Gasior.

²⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 20.03.14, deklarata e Riza Berishës, faqe 16; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 03.07.14, deklarata e Behlul Limajt, faqe 22.

²⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 15.05.14, deklarata e Alush Hazrollit; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 16.05.14, deklarata e Mustafë Limajt, faqe 29; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 22.09.14, deklarata e Ismail Hazrollit, faqe 9.

²⁸ Prova 1.4, Raport i përgjithshëm Informues i ekspertit nga Tefik Gashi dhe Hazir Kelmendi, zyra e ekspertizës së mjeko-ligjore MONKON, 13.06.11, faqe 27.

²⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 05.02.14 dhe 04.03.14, deklarata e Ilir Limajt; Gëzhoja e gjetur në pozicionin EV-10 e gjetur në armën e Beratit, shikoni Provën 1.4, Raport i përgjithshëm informues i ekspertit nga Tefik Gashi dhe Hazir Kelmendi, zyra për ekspertizën mjeko-ligjore MONKON, 13.06.11, faqe 27.

prapme e këmbës së tij të majtë dhe nën gjurin e majtë ishte lënduar nga plumbi, një prej pjesëve të plumbit e theu ashtin dhe hyri brenda në palcë.³⁰

30. Berati gjithashtu qëllloi nga pika afër pozicionit EV14 me pushkën e tij në drejtim të PR6 aty ku Azemi vrapoi për të ndihmuar Skenderin.³¹ Plumbi e qëllloi atë në pjesën e epërme të gjurit të tij të djathtë, duke shkaktuar një plagë e cila i dëmtoi lëkurën, nën indin e lëkurës, kokën e kërcit dhe fyellit të këmbës, duke e këputur plotësisht nervin peroneal të djathtë.³²
31. I pandehuri ka ikur nga vendi i ngjarjes pas 5-15 minutash. Hazir Krasniqi e ka përcjellë së paku Eminin në Audi-në A-6 e hirtë të përmendur më parë.³³ Alush, Ismajl dhe Haxhi Hazrolli, Veli Limaj dhe policia kanë arritur në restorant dhe Azemi, Iliri dhe Skenderi ishin dërguar në spital.
32. Më 2 janar 2011 rreth orës 19:00, policia kishte ardhur në shtëpinë e familjes Krasniqi dhe ka arrestuar Emin, Durim dhe Berat Krasniqin. Durimi dhe Berati kanë njoftuar policinë se ku gjendeshin armët. Ato ishin rreth 40 metra larg nga restoranti Oda dhe ato ishin fshehur në shkurre.³⁴ Hazir dhe Astrit Krasniqi ishin arrestuar gjithashtu.

III. Faktorët shtesë lidhur me vlerësimin e provave

Besueshmëria e dëshmitarëve

33. Trupi gjykues ka vlerësuar me kujdes deklaratat e dëshmitarëve dhe ka ardhur në përfundim se ato në përgjithësi janë të besueshme dhe të qëndrueshme. Nuk janë gjetur kundërthënie

³⁰ Prova 1.4, Raport i përgjithshëm informues i ekspertit nga Tefik Gashi dhe Hazir Kelmendi, zyra për ekspertizën mjeko-ligjore MONKON, 13.06.11.

³¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, deklarata e Azem Limajt, faqe 18: “Berati e mbushi armën (...) pastaj ai më qëllloi në këmbë dhe unë u rrëzova”. Gëzhoja e gjetur në pozitën EV10 e gjetur në armën e Beratit, shikoni Provën 1.4, Raport i përgjithshëm informues i ekspertit nga Tefik Gashi dhe Hazir Kelmendi, zyra për ekspertizën mjeko-ligjore MONKON, 13.06.11, faqe 27.

³² Prova 1.4, Raport i përgjithshëm informues i ekspertit nga Tefik Gashi dhe Hazir Kelmendi, zyra për ekspertizën mjeko-ligjore MONKON, 13.06.11.

³³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 18.03.14, deklarata e Veli Limajt, faqe 5-6. Deklarata e Veli Limajt në stacionin policor në Malishevë, 02.01.2011, 00:35hrs. Veli Limaj po i afrohej restorantit nga një rrugë e ngushtë që qonte tek vendparkimi, sepse Ismajl Hazrolli e kishte thirrur atë për ndihmë. Atij iu desh të kalonte shumë afër veturës së Hazirit në atë rrugë dhe mundi ta njihte Hazirin që po bënte thirrje me telefon celular derisa po voziste shumë ngadalë.

³⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 24.04.14, deklarata e Avni Krasniqit.

thelbësore me deklaratat e mëparshme, përveç disa ndryshimeve të vogla të cilat duhet të priten duke marrë parasysh kohën e gjatë që ka kaluar nga ngjarja dhe nga deklaratat e tyre të para, me ato të dhëna para gjykatës. Gjykata ka ardhur në një vështrim të përgjithshëm se dëshmitarët okularë nuk e japin gjithmonë deklaratën e saktë për secilën hollësi, veçanërisht në rastin kur dikush përqendrohet për të shpëtuar jetën e tij apo saj në një situatë kur jeta është e kërcënuar.

34. Trupi gjykues ka vlerësuar hartat dhe hapësirën e restorantit gjatë inspektimit të vendit të ngjarjes më 3 shtator 2015.³⁵ Së bashku me deklaratat e dëshmitarëve dhe dëshmitarëve ekspertë, trupi gjykues ka gjetur se dëshmitarët okularë ishin në pozita nga të cilat kanë mundur të dëshmojnë lidhur me ngjarjet që ata kanë përshkruar. Për më tepër, ata gjithashtu në mënyrë të qartë kanë deklaruar se në cilat raste ata e kishin të pamundur të shohin ngjarje të caktuara.
35. Thënë në përgjithësi, trupi gjykues i konsideron dëshmitë e familjarëve Limaj me disa rezerva. Veçanërisht deklaratat e Behlul, Azem dhe Ilir Limajt, se ka qenë një grup i madh i njerëzve që kanë hyrë në restorant dhe i kanë sulmuar ata, është gjetur të jetë e ekzagjeruar. Ato janë plotësisht të paqëndrueshme në krahasim me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë të cilët flasin për një grup prej 3 deri në 6 meshkuj. Edhe pse nuk mund të përjashtohet, trupi gjykues nuk ka gjetur prova përfundimtare se të pandehurit kanë qenë të shoqëruar nga më shumë persona.
36. Megjithatë, përshkrimet siç janë prezantuar nga dëshmitarët Limaj japin një ide të përgjithshme të invadimit të të pandehurve në restorant. Ata kanë deklaruar se Emini, Durimi, Berati dhe Haziri kanë qenë në restorant në kohën e kryerjes së krimit, se Emini e ka goditur Skender Limajn me një shufër metalike dhe se Durimi dhe Berati kanë përdorur nja armë AK-47. Më e rëndësishmja, këto deklarata janë konfirmuar nga raportet e Tefik Gashit, Hazir Kelmendit dhe Flamur Blakajt, në lidhje me plagët e palëve të dëmtuara dhe nga provat balistike. Dëshmitë e kamerierëve të cilët ishin të pranishëm gjatë kohës kritike përshkruajnë ngjarjen me besueshmërinë më të madhe. Ata kanë treguar se kush ka qenë në restorant, cilat ishin veprimet e secilit person dhe se ka pasur të pranishëm edhe fëmijë.

³⁵ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, inspektimi i vendit të ngjarjes, 03.09.15.

37. Në mënyrë më specifike, dëshmia e Ilir Limajt është në përputhje me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë okularë në çështjet kyçe. Nga pozicioni i tij Iliri ka mundur të vërejë veprimet kriminale e gjithashtu edhe kryesit e tyre, veçanërisht kur ata kanë hyrë në restorant. Ai i ka njohur të pandehurit, Eminin dhe Hazirin.
38. Azem Limaj deklaroi se në mbrëmjen kritike ai ishte në restorantin Kështjella i ulur në tavolinën pranë dritares dhe banakut me Mustafë Limajn dhe dy kushërinjtë e tij. Ai theksoi se i ka njohur të gjithë, ai i njihte shumë mirë Emin dhe Hazir Krasniqin sepse së bashku me Gani Krasniqin (babain e Eminit, ish-kryetarin e komunës së Malishevës, vozitës i të cilit ishte Haziri) ishin klientë të rregullt të atij restoranti. Për më shumë, ai e njihte të birin e Imerit, Berat Krasniqin. Gjykata gjen se dëshmia e Azemit në përgjithësi është e besueshme. Ajo është në përputhje me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë okularë në çështjet kyçe.
39. Deklaratat e Behlul Limajt në përgjithësi janë në përputhje me deklaratat e Ilirit dhe Azemit dhe me ato të dëshmitarëve të tjerë okularë. Ai theksoi se kur filluan krimet, ai ishte i ulur në tavolinën 19, pastaj u zhvendos tek shtylla mes tavolinës 17 dhe 19 afër oxhakut për t'u fshehur dhe më pastaj ai shkoi nën këto tavolina afër pozicionit EV12 për t'u fshehur. Nga dy pozitat e tij të para ai kishte një pamje të shkëlqyeshme të kryesve kur ata hynë në lokal. Ai konfirmoi deklaratat e Azemit dhe Ilirit të cilët e panë Hazirin, dhe pa edhe Eminin duke goditur Skenderin me shufër metalike si edhe Beratin duke shtënë me AK 47 drejt Ilirit dhe Azemit. Është e besueshme se ai mundi t'i njihte ata sepse ai ata i njihte shumë mirë, veçanërisht Hazirin dhe Eminin.
40. Riza Berisha kishte treguar se kush gjendej në restorant në momentin kur kishin hyrë të pandehurit. Ai gjithashtu dha një shpjegim të hollësishëm mbi Astritin dhe aktivitetet e tij të bëra me telefon. Trupi gjykues e sheh dëshminë e tij si të besueshme dhe shumë relevante. Ajo është në përputhje me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë okularë në lidhje me çështjet kyçe.
41. Arben Shala njohu Astritin pasi që kishte punuar për axhën e tij në Malishevë ku kishin prodhuar dyer dhe dritare dhe e kishte parë atë çdo javë. Arbeni kishte qenë në gjendje të vërejë se Skenderi ishte goditur me shufra metalike sepse tavolina e tij ishte afër me atë të Skenderit.

Mirëpo ai nuk kishte mundur ta shohë se në cilën pjesë të trupit ishte goditur Skenderi sepse mes tyre ishte një shtyllë e betonit.

42. Valon Shala konfirmoi pjesë të deklaratës së kushëririt të tij Arbenit. Ai gjithashtu theksoi se Astriti shkoi në tualet dhe u kthye, dhe pas 10 deri 15 minutash pasi që u zhduk Astriti, ndodhën krimet. Megjithatë, pjesa ku ai përshkruan se kryesit u kthyen në restorant dhe shtien prapë edhe disa plumba, nuk është e besueshme.³⁶ Ai është dëshmitari i vetëm i cili deklaroi se ata ishin kthyer. Gjykata nuk i bazon të gjeturat e tyre në deklaratën e tij përveç në pjesën që janë në përputhje me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë.

43. Deklaratat e Haxhi, Alush dhe Ismajl Hazrollit janë bindëse, logjike dhe në pjesën më të madhe në përputhje me njëra-tjetrën.

44. Deklaratat e Veli Limajt janë gjetur si të besueshme. Trupi gjykues është i bindur se përkundër territ dhe mjegullës, ai ishte në gjendje të identifikojë Hazirin si vozitës i Audi-së së hirtë duke pasur parasysh afërsinë mes dy veturave dhe veçanërisht pasi që ai e njohte Hazirin për vite të tëra si vozitës i kryetarit të komunës. Trupi gjykues e di nga inspektimi i vendit të ngjarjes se rruga e vogël që qon në vend-parkimin e restorantit – ku janë takuar veturat – është shumë e ngushtë. Mund të kalojnë dy vetura pranë njëra tjetrës mirëpo nuk ka më shumë hapësirë. Dritat e veturës së tij i bënë të mundur Veliut të shihte një pjesë të numrit të regjistrimit, llojin dhe ngjyrën e veturës, dhe Hazirin si vozitës të saj. Për të njëjtat arsye Gjykata e gjen të besueshme se Veli Limaj i ka parë tytat e armëve brenda në veturë mes ulëses së vozitësit dhe të udhëtarit.

45. Trupi gjykues vlerëson se Hazir Kelmendi dhe Tefik Gashi dhanë deklarata të besueshme dhe mirë të bazuara siç u përmend më lart. Për më tepër, trupi gjykues gjen baza të mjaftueshme të mbështetet në raportet e tyre. Për sa i përket diskutimit lidhur me atë nëse këta ekspertë janë të kualifikuar mjaftueshëm, ajo i referohet paragrafëve që mbulojnë pranueshmërinë e provave më lart.

Personazhi i planifikuar

³⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 22.07.14, deklarata e Valon Shalës, faqe 26.

46. Trupi gjykues gjen se nga rrethanat e takimit në restorantin Oda si dhe ngjarjet pasuese, mund të nxirret përfundimi që ata kanë bërë plan për të shkuar në Restorant ‘Kështjella’ – pronë e familjes së dëmtuar Limaj – të njëjtën mbrëmje, për të shkaktuar dëm ndaj njërit apo më shumë anëtarëve të kësaj familje.

47. Në këtë kuptim, trupi gjykues e gjen si relevante se gjatë kohës derisa Astriti gjendej në restorant ‘Kështjella’, ai ishte parë të ketë lëvizur herë brenda herë jashtë, dhe SMS-të në vijim ishin dërguar në telefonin e tij nga telefoni i Emini. (Nuk kontestohet se këta numra i kanë takuar dhe ishin në shfrytëzim nga Emin dhe Astrit Krasniqi në kohën kritike.)³⁷

01.01.2011, 17:52hrs, SMS i dërguar nga Emini tek Astriti: “A ke shkuar atje, a ka diçka aty.”

01.01.2011, 18:14hrs, SMS i dërguar nga Emini tek Astriti: “Mos gënje. Kush është aty, më trego.”

01.01.2011, 18:15hrs, SMS i dërguar nga Emini tek Astriti: “A ke para. Nëse nuk ke më trego, sepse ata po vijnë tani.”

01.01.2011, 18:45hrs, SMS i dërguar nga Emini tek Astriti: “A ka ardhur ndonjë mysafir i ri”.

Motivi: hakmarrje e paskrupullt

48. Kur merren parasysh rrethanat e ngjarjes, trupi gjykues gjen se ekzistojnë baza për të përfunduar se motivi i veprave penale të këtij rasti është si pasojë e një mosmarrëveshje e cila ka ndodhur gjatë zgjedhjeve të mbajtura më 12 dhjetor 2011 dhe përfundimisht kjo ka qar në Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit të datës 16 mars 2012.³⁸ Atë ditë, një zënkë mes njerëzve nga Banja dhe atyre nga Carralluka ka shpërthyer në shkollën fillore në Banjë e cila kishte shërbyer si vendvotim atë ditë. Behlul Limaj, anëtar i familjes Limaj, si pasojë ishte shpallur fajtor për posedim dhe përdorim të paautorizuar të armës, dhe Vesel Krasniqi (që nuk është i afërm i të pandehurve) ishte shpallur fajtor për grushtimin e Hazir Krasniqit – i pandehur në këtë rast –

³⁷ Prova 25 (regjistrator i veçantë), Raporti i PTK-së për porositë e shkurtra SMS të pranuar nga nr. 45282353 – Emin Krasniqi.

³⁸ Prova 11.1, Gjykata e Qarkut në Prizren, P. Nr. 44/2011, 16.02.2012.

derisa ai ishte në veturën e tij gjatë zënkës me fjalë. Hazir Krasniqi dhe Behlul Limaj që të dy kanë dhënë deklaratë të hollësishme lidhur me incidentin gjatë shqyrtimit gjyqësor.³⁹ Edhe pse prapavija e plotë (politike) e mosmarrëveshjes mes dy familjeve siç është shpjeguar nga Behlul Limaj më 3 dhe 7, 21 korrik 2014⁴⁰, mbetet e pakonfirmuar, përmbajtja e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit e datës 16 mars 2012, e cila është vërtetuar nga Gjykata Supreme, në mënyrë të qartë tregon ngatërresën që ka ekzistuar në mes së paku Hazir Krasniqit dhe Behlul Limajt.⁴¹

49. Trupi gjykues vjen në përfundim se motivi prapa vrasjes së Skenderit ishte ‘hakmarrje e paskrupullt’, siç është paraparë sipas paragrafit 9 të nenit 147 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës dhe siç edhe është referuar në fjalën përfundimtare të prokurorit. Të pandehurit donin t’i shkaktojnë dëm familjes Limaj për të keqen të cilën – në sytë e tyre – e kishin kryer anëtarët e familjes Limaj ndaj Hazir Krasniqit gjatë zgjedhjeve të mbajtura më 12 dhjetor 2010 në fshatin Banjë. Hakmarrja ishte ‘e paskrupullt’ për shkak të sjelljes së vrazhdë, të papërmbajtur sipas së cilës Emin Krasniqi kishte sulmuar jo të dyshuarin Skender Limaj, i cili ishte i rrethuar nga fëmijët.

Shkaku i vdekjes së Skender Limajt

50. Flamur Blakaj është patolog i forenzikës i cili kreu autopsinë e trupit të Skender Limajt më 3 janar 2011 dhe ka përpiluar raportin e autopsisë.⁴² Marek Gasior ka monitoruar autopsinë dhe ishte i pranishëm në morg mirëpo ai vetë nuk ka shtuar asgjë në raport. Ai ishte dëgjuar nga trupi gjykues dhe nga palët përmes video-linkut me Poloninë, me kërkesë të mbrojtjes. Ai shpjegoi procedurën e autopsisë dhe deklaroi se mbështet raportin e autopsisë të përpiluar nga Blakaj.⁴³

³⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 02.02.16, deklaratë e të pandehurit Hazir Krasniqi, faqe 23; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 21.07.14, deklaratë e Behlul Limajt.

⁴⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 03.07.14, deklaratë e Behlul Limajt, faqe 7 e më tutje, “Unë dot të duhej të kisha qenë i vrarë, jo Skenderi”.

⁴¹ Prova 11.1, Gjykata e Qarkut në Prizren, P. Nr. 44/2011, 16.02.2012; Prova 11.2, Gjykata Supreme e Kosovës, Ap. Nr. 258/2012, 17.10.2012

⁴² Prova 1.2, Raporti i Autopsisë, MA 11-001, Dr. Flamur Blakaj, 03.01.11.

⁴³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 20.08.15, deklaratë e Marek Gasior.

51. Raporti i autopsisë përmend shkakun e vdekjes si në vijim: “Plagë depërtuese në hapësirën e legenit të shkaktuar nga veprimi dinamik i plumbit të shkrepur nga arma e zjarrit; Lëndim në tru (contusion cerebri) dhe gjakderdhje nën membranën e butë të trurit.”
52. Për më tepër, Hazir Kelmendi dhe Tefik Gashi së bashku kanë dorëzuar një raport me shkrim nga këndvështrimi balistik dhe mjekësor. Aty thuhet se:
“Vdekja është e dhunshme dhe vjen si rezultat i mavijosjeve masive të indit trunor dhe gjakderdhjeve nën membranat e buta të trurit, nga fraktura të eshtrave të lobit, si pasojë e goditjeve mekanike/ veprimit të “rrahjes” me armë të fortë dhe të furishme – siç është konkluduar nga patologu/ dhe ndihmuar gjithashtu edhe përmes çarjes së pjesëve abdominale të trupit / zorrës dhe kordës / dhe duke e derdhur përmbajtjen e tyre në çarjen abdominale, dhe gjithashtu edhe gjakderdhja ‘e tepruar’, si rezultat i veprimit dinamik të plumbit të shkrepur nga arma e zjarrit.”
53. Në gjykatë, që të dy dëshmitarët ekspertë Flamur Blakaj dhe Tefik Gashi kanë deklaruar se më shumë se 50 % e shkakut të vdekjes është shembja e trurit. Për më shumë Gashi tha se plumbi i cili ishte shkrepur nga AK47, nuk ka dëmtuar asnjë organ vital dhe se më me gjasë ai do të kishte mbijetuar nëse nuk do të kishte dëmtim të trurit. Ai gjithashtu theksoi se lëndimi nga e shtëna do të kishte qenë fatal nëse do të kishte mbetur e patrajtuar. Trupi gjykues gjen se nuk ekziston asnjë arsye të mos ndiqet ky përfundim, dhe nuk sheh kurrfarë kundërtënie me deklaratën e Flamur Blakajt dhe përfundimin e dhënë në raportin e autopsisë. Ky përfundim më tepër është specifikuar nga deklarata e Tefik Gashit.
54. Trupi gjykues nuk e ndjek sugjerimin e mbrojtjes se lëndimi në kokë i Skender Limajt ishte shkaktuar gjatë rënies në tokë. Tefik Gashi ka treguar për frakturat tipike të shkaktuara nga një objekt i topitur dhe theksoi se fraktura nuk është në përputhje me rrëzimin mirëpo me goditjen nga një objekt i topitur. Siç është theksuar nga shumë dëshmitarë, vendi ku ishte i ulur ai dhe ku ishte rrëzuar, ka pasur dysheme të drurit. Për më shumë, dëshmitarët ekspertë kanë deklaruar se nëse ai do të vdiste gjatë rrëzimit me kokë, ai do të duhej të binte me kokë teposhtë, dhe me

këmbë lart.⁴⁴ Vështirë se është kështu duke marrë parasysh pozitën (qëndrimin ulur, pastaj ngritjen në këmbë) në të cilën gjendej ai.

55. Duke marrë parasysh përmbajtjen e raportit të autopsisë, raporti i Blakajt dhe Gashit, si dhe deklaratat e dëshmitarëve ekspertë në gjykatë, trupi gjykues gjen baza të mjaftueshme për të nxjerrë përfundimin se shkak i vdekjes ishte goditja në kokë me një objekt (të topitur), në këtë rast me shufër metalike.

IV. Faktorët në lidhje me tregimin e ofruar nga mbrojtja

56. Të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës ofruan shpjegim alternativ se ata ishin të parët që ishin sulmuar nga familja Limaj, dhe për pasojë kanë vepruar në vetëmbrojtje. Durim Krasniqi tha: “Kur ne shkuam në atë restorant, hymë brenda dhe e pamë Eminin i cili ishte i shtrirë në tokë. Aty ishin disa meshkuj, të cilët e kishin goditur Eminin dhe të cilët shtien në ne me armë. Ne dolëm jashtë dhe i morëm armët që i kishim përdorur për të shtënat gjatë natës së Vitit të Ri dhe u kthyem brenda dhe ne ato armë i morëm për vetëmbrojtje, për të mos sulmuar askënd. Kur e pashë Eminin në atë gjendje dhe ata burra me armë, (...) ata filluan të shtinin dhe si vetëmbrojtje unë kam shtënë vetëm tri apo katër herë në tokë, nuk më kujtohet saktë e pastaj e kemi marrë Eminin dhe e kemi tërhequr atë nga aty.”⁴⁵

57. Pas vlerësimit të kujdesshëm të shkresave të lëndës, provave dhe deklaratave të dëshmitarëve, trupi gjykues e konsideron këtë version si të pabesueshëm dhe të pambështetur nga faktet. Armët nuk janë përdorur vetëm nga të pandehurit për të shtënë në tokë dhe për të mbrojtur veten. Për më tepër, trupi gjykues e sheh si relevante të përmend faktin që disa dëshmitarë kanë dëshmuar në mënyrë të qëndrueshme se personat që kanë hyrë në restorant kanë bërë titur “Ku jeni ju bijtë e Gjokës?”. Trupi gjykues e hedh poshtë mundësinë se të gjithë këta dëshmitarë në mënyrë të rastësishme kanë thënë saktësisht të njëjtat fjalë. Për pasojë, duke marrë parasysh se këto kanë qenë të bërë titurat pas hyrjes, trupi gjykues gjen se kjo mbështet tregimin se personat që kanë hyrë nuk ishin sulmuar, mirëpo ishin ata të cilët e filluan dhunën.

⁴⁴ Ibid, faqe 11.

⁴⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 28.01.16, deklarata e Durim Krasniqit, faqe 7.

58. Më tutje, trupi gjykues gjen si relevante të përmend se edhe në qoftë se me të vërtetë Durimi dhe Berati shkuan në veturat e tyre për të marrë armët dhe për të mbrojtur Eminin, ata do të mund, apo kanë mundur, të marrin parasysh mundësinë për të ri-vlerësuar gjendjen dhe të zgjedhnin qasje alternative, më saktësisht për të thirrur policinë për ta shpëtuar Eminin.
59. Trupi gjykues më tutje nuk e vlerëson si të besueshme faktin se të pandehurit ishin sulmuar, sepse ata thjeshtë shkuan në shtëpi më pas pa i përfshirë autoritetet, edhe derisa Emini ishte i lënduar. AK-47-at më pastaj ishin fshehur në shkurre, dhe kjo e shton pambështetshmërinë e ngjarjeve të pretenduara nga të pandehurit.
60. Shpjegimi i Berat Krasniqit mbi praninë e tij në vendin e krimit duke deklaruar se ai e përcillte Eminin, i cili po shkonte që ta merrte Astritin, nuk është e besueshme. Sipas të pandehurit, ai së bashku me Durimin e përcollën me veturë Eminin sepse ishin të frikësuar se ai mund të shkaktonte aksident pasi që ishte i dehur. Ata vendosën të shkojnë pas tij disa minuta pasi që e panë atë të kalojë kah restoranti. Mbetet e pashpjegueshme pse ata shkuan pas tij vetëm pasi që ai veç po voziste për disa minuta, pasi që veç e dinin se ai ishte i dehur në kohën kur kishte dalë nga Oda. Duke marrë parasysh faktin se ata nuk e dinin se ku po shkonte ai dhe duke marrë parasysh edhe motin me mjegull, është vështirë të besohet se ata ishin në gjendje të ngriheshin, të shkonin brenda në veturë dhe ta përcillnin atë deri tek restorant 'Kështjella', gjatë tërë kohës derisa Emini vazhdonte të voziste dhe nuk ishte në dijeni se po përcillej.
61. Disa dëshmitarë kanë theksuar se nuk ka muzikë të gjallë të rregullt në restorantin 'Kështjella', mirëpo vetëm për ndeja të dasmave apo festa të tjera.⁴⁶ Nuk ekziston kurrfarë prove se në mbrëmjen kritike do të kishte ndonjë muzikë. Prandaj, deklarata e Astrit Krasniqit që kishte shkuar tek restoranti 'Kështjella' për të dëgjuar muzikë të gjallë, nuk mund të ndiqet.
62. Nuk ekziston asnjë provë se vendi i krimit, duke përfshirë edhe vendin ku ishin gjetur gëzhojat dhe arkat, ishin prekur apo kontaminuar siç është sugjeruar nga mbrojtja. Kjo tashmë është konkluduar nga Gjykata e Apelit në aktvendimin e saj të nxjerrë më 14 tetor 2013. Më tutje trupi

⁴⁶ Për shembull: procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 25.04.14, deklarata e Haxhi Hazrollit, faqe 29.

gijkues i referohet deklaratave të oficerëve të policisë që përshkruan mënyrën se si ishte siguruar vendi i krimit,⁴⁷ dhe raporti nga inspektimi i vendit të ngjarjes.

63. Për arsyet e lartpërmendura, trupi gjykues gjen se fjalët e shkruara siç janë përshkruar nën titullin ‘deklaratë mbi faktet’ është më e besueshme se sa ajo e përshkruar nga të pandehurit.

V. Lirimet nga akuzat

Durim Krasniqi për Pikën 1

64. Durimi lirohet për shkak se nuk janë gjetur gjurmë që e ndërlidhin plumbin e gjetur në trupin e Skenderit me armën që e posedon Durimi. Trupi gjykues i referohet raportit të përpiluar nga Tefik Gashi dhe Flamur Blakaj.⁴⁸ Aty thuhet se:

“Afër banakut, në anën e tij të djathtë, te shtylla e IV, është shtirë gjithashtu me një armë tjetër automatike AK-47, pa kondak, i kalibrit 7,62 x 39 mm., me numër serik nr. 074949-89, prodhim shqiptar, brenda të cilës kishte mbetur një gëzhjojë, e regjistruar si: EV#11. Gjithashtu, ky person në mënyrë që ta pozicionojë gëzhjojën në atë pozitë, është dashur të shtijë në drejtimin e karrigeve të dëmtuara, në anën e majtë të sallës. Në dokumentet mjekësore të shkresave të lëndës është ardhur në përfundim se në trupin e tani të ndjerit Skender Limaj, është gjetur një predhë, e shënuar si prova materiale: D#1, e cila i takon kalibrit: 7,62 x 39 mm dhe i ka karakteristikat e klasës së predhave të pushkës automatike: AK-47, me nr. 074949-89, megjithatë kjo predhë, nuk ka karakteristika të mjaftueshme individuale për të ardhë në përfundim nëse është shtirë nga kjo pushkë automatike ose jo.(...) Kjo armë është marrë nga i pandehuri Durim Krasniqi”.⁴⁹

⁴⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 30.10.14 dhe 11.11.14, deklaratat nga Faton Morina dhe Xhavit Kryeziu.

⁴⁸ Prova materiale 1.4, Raporti informativ i ekspertit të përgjithshëm nga Tefik Gashi, ekspert i forenzikës, dhe Hazir Kelmendi, ekspert i balistikës, zyra e ekspertizës ligjore mjekësore MONKON në lidhje me lëndimet e Azem dhe Ilir Limaj dhe raporti i autopsisë së Skender Limaj, 13.06.11.

⁴⁹ Ibid, faqe 24.

65. Dëshmitari ekspert Hazir Kelmendi e ka shtjelluar edhe më tej se nuk ka mundur të vërtetohet se ka qenë plumb nga arma e Durimit. Sipas ekspertit, karakteristikat e plumbit të gjetur në trupin e Skenderit janë të ndërlidhura me një AK47 si ai i përdorur nga Durimi; megjithatë nuk ka mundur të thotë me siguri se ky plumb i takon AK47 të Durimit.⁵⁰ Predha ishte aq e dëmtuar sa që i mungonin veçantitë individuale:

“Kjo predhë ka karakteristika klasike të armëve të cilat janë kontrolluar dhe dorëzuar nga Durim Krasniqi dhe Berat Krasniqi. Megjithatë, kjo predhë nuk ka karakteristika individuale për ta identifikuar tytën nga e cila është shtënë ky plumb. Kjo përfshin të dy armët nga Durim dhe Berat Krasniqi. (...) Gëzhoja e cila e mbështjell plumbin është larguar nga predha. Kjo predhë, tyta e armës i ka katër vjaska të cilat e rrotullojnë predhën nga tyta dhe këto vjaska shfaqen në këmishëz. Megjithatë, në armët që nuk kanë këmishëz, plumbat apo predhat nuk mund të identifikohen.”⁵¹

“Është e vështirë të drejtohet këmishëza pasi që është e fortë dhe vjaskat dëmtohen, dhe ato janë shtyre, janë dëmtuar kështu që nëse mundohemi t’i drejtojmë ato do të dëmtohen edhe më shumë, është e vështirë që ndokush ta qartësojë. Në Kosovë jemi marrë shumë me armë, predha, ndërsa për vendet tjera këto gjëra nuk kanë qenë me interes. (...) Nëse do të isha në gjendje ta shoh predhën e dëmtuar, do të mund të ofroja përgjigje më të sigurte, por laboratorët nuk i rregullojnë këmishëzat e dëmtuara në mënyrë që të krahasohen dhe të ofrohet përgjigje e saktë.”⁵²

66. Duke u bazuar në atë që u tha më lart, Trupi gjykues nuk ka qenë në gjendje të vërtetojë përtej dyshimit të arsyeshëm se Durimi e ka shtënë plumbin i cili është gjetur në trupin e Skenderit.

67. Për më tepër, Trupi gjykues mendon se është me rëndësi të theksohet se asnjë dëshmitar nuk ka dëshmuar se Durimi ka shtënë në Skenderin.

68. Si pasojë e kësaj, nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri e ka kryer veprimin me të cilin akuzohet. Prandaj, ai do të lirohet nga kjo akuzë.

⁵⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 12.02.15.

⁵¹ Ibid, faqet 5-6

⁵² Ibid, faqet 14-15

Emin Krasniqi për Pikën 2

69. Azem Limajt nuk i kujtohet kush i ka rënë me shufër të hekurt.⁵³ Për më tepër, nuk ka asnjë dëshmitar tjetër i cili dëshmon se Emini ka qenë i përfshirë në rrahjen e Azemit me shufër metalike. Andaj, nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri e ka kryer veprën për të cilën akuzohet. Prandaj, ai do të lirohet nga kjo akuzë.

Astrit Krasniqi për Pikën 4

70. Sipas Nenit 25 dhe 27 të KPPK, përgjegjësia penale duhet të limitohet në ‘dashje’. Trupi gjykues konsideron se nuk është vërtetuar se Astriti ka qenë në dijeni për atë që kanë bërë të tjerët, apo se të tjerët ia kanë shpjeguar atij atë që kanë dashtë ta bëjnë. Ai i ka kryer veprat pa e ditë se do të përfundojnë në vrasje të rëndë. Përmes kontaktit me SMS me Eminin (“tregom kush është aty, mos rrej”), ai ka mundur të presë se ata do t’i ‘rahatonin’, por mendimi i Trupit gjykues është se përfundimi me një person të vrarë nuk ka qenë diçka që ai ka mundur ta marrë parasysh në mënyrë të arsyeshme.

71. Trupi gjykues konsideron se është relevante të theksohet se Astriti është punëtor i kompanisë së Eminit, prandaj edhe nuk mund të përjashtohet fakti se pozita e tij nuk i ka lejuar ta refuzojnë ndonjë detyrë të cilën ia ka caktuar Emini. Në mungesë të dashjes, nuk është dëshmuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën për të cilën është akuzuar. Prandaj, ai do të lirohet nga kjo akuzë.

VI. Përgjegjësia Penale dhe Klasifikimi Ligjor

PIKA 1 (Emin Krasniqi)

⁵³ Procesverbali i shryrtimit gjyqësor, 13.03.14, deklarata e Azem Limaj, faqe 18.

72. Trupi gjykues gjen se Emin Krasniqi, duke i rënë Skender Limajt në kokë me shufër të metaltë, ka treguar dashje për ta privuar Skenderin nga jeta. Gjasat janë shumë të mëdha që vdekja të jetë pasojë nga rënia me një objekt aq të fortë dhe të rëndë në një pjesë aq të ndjeshme të trupit, të cilën Emmini është dashur ta marrë parasysh.
73. Trupi gjykues gjen se Emin Krasniqi ka vepruar në një mënyrë jashtëzakonisht të dhunshme dhe agresive duke e rrahur Skender Limajn me shufër të metaltë. Veprimi i rënies së Skenderit me shufër në kokë jo vetëm që mund të përcaktohet si i ‘pamëshirshëm’, por ai gjithashtu nuk ka shfaqur as dhembshuri, sidomos ndaj fëmijëve të cilët ishin duke shikuar TV së bashku me Skenderin në të njëjtën tavolinë dhe u bënë dëshmitarë okularë të vrasjes së babait të tyre. Viktima nuk ka pritur ndonjë sulm dhe nuk ka pasur mundësi ta mbrojtë veten.
74. Për më tepër, dëshmitarët ekspertë Tefik Gashi dhe Flamur Blakaj, të dy kanë deklaruar se Skenderi, edhe pse për një kohë të shkurtër, ka vuajtur dhimbje të jashtëzakonshme.
75. Prandaj, Trupi gjykues ka arritur në përfundim se kjo vrasje ka qenë vrasje e rëndë sipas paragrafit 5 të Nenit 147 të KPPK.
76. Më tej, siç është shpjeguar më parë, Trupi gjykues konsideron se motivi për vrasje mund të gjendet në aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prizrenit, me të cilin janë dënuar Vesel Krasniqi dhe Behlul Limaj dhe e cila vërteton se ka ekzistuar konflikti në mes të familjes Limaj dhe familjes Krasniqi, prej të cilit Skender Limaj ishte viktimë e pafat.
77. Prandaj, përveç paragrafit 5 të Nenit 147 të KPPK, Trupi gjykues konsideron se kjo vrasje ishte gjithashtu vrasje e rëndë për shkak se është kryer për arsye të hakmarrjes së paskrupullt, sipas paragrafit 9 të të njëjtit nen.
78. Trupi gjykues e hedh poshtë referencën e bërë nga mbrojtja për gjendjen e dehur të Emminit atë mbrëmje. Cilido qoftë niveli i alkoolit në gjakun e tij në kohën e kryerjes së veprimit, Emmini me dashje dhe me qëllim e ka sjellë veten në atë gjendje, prandaj edhe mund të (*culpa in causa*) konsiderohet se mban përgjegjësi penale për veprat të cilat i ka kryer nën atë ndikim.

PIKA 2 (Berat Krasniqi)

79. Trupi gjykues konsideron se duke shtënë në drejtim të Azem Limajt të lënduar dhe duke i rënë në pjesën e sipërme të gjurit të tij, e kështu duke i shkaktuar plagë e cila ia ka dëmtuar lëkurën, indet nën lëkurë, kokën e kërcit dhe fyellit të këmbës, që e ka prerë nervin e muskulit të dhjathtë, sulmi me AK47 është kryer me qëllim të shkaktimit të lëndimeve të rënda trupore.

80. Më tej, Gjykata e ka vlerësuar rëndesën e lëndimeve dhe ndikimin që ato kanë pas në jetën e përditshme të Azemit.

81. Pas udhëzimeve të Gjykatës, edhe Azemi edhe Ilir Limaj i janë nënshtruar një kontrolli shtesë mjekësor në mënyrë që të vërtetohet ndikimi i lëndimeve në jetën e tyre të përditshme. Më 23 tetor 2015, të dytë janë kontrolluar në Departamentin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë nga mjeku i forenzikës Flamur Blakaj.⁵⁴

82. Sa i përket lëndimeve të Azem Limajt, mjeku Flamur Blakaj ka marrë parasysh si në vijim:

“Lëndimet e përshkruara sipas të Gjeturave – Konkluzioneve janë: Plagë penetruese e shkaktuar nga armë zjarri në pjesën e jashtme të regjionit të gjurit të djathtë. Thyerje të shumta fragmentare të kokës së kërcit në pjesën e sipërme të muskulit tibia. Lëndim në nervin e djathtë peroneal të shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së shkrepur nga arma e zjarrit, e cila përfshihet në plagë të rëndë trupore, plagë të cilat nuk e kanë rrezikuar jetën e personit në kohën e shkaktimit të tyre.

(Arsyetimi: Plagët nuk e kanë rrezikuar jetën e personit në kohën e shkaktimit të tyre sepse organet vitale trupore nuk janë ndikuar dhe enët kryesore të gjakut nuk janë dëmtuar gjë që do të çonte drejt shokut hemorragjik).

Këto plagë kanë shkaktuar dëmtime të përhershme dhe dobësim të funksionit të muskulit të pulpës së këmbës së djathtë dhe paaftësi për lakimin e shputës.

⁵⁴ Prova materiale 26: Ekspertiza nga mjeku ligjor Flamur Blakaj, Departamenti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, 25 tetor 2015.

(Arsyetimi: Dëmtimi dhe dobësimi është i natyrës së përhershme si pasojë e dëmtimit të nervit peroneal të këmbës së djathtë përkundër intervenimit kirurgjik plastik korrigjues të nervit suralis).

Këto lëndime kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm dhe dobësim të funksionit të muskullit të pulpës së djathtë gjë që ka pas ndikim në procesin e lëvizjes (ecjes).

(Arsyetimi: Dëmtimi i përkohshëm dhe dobësimi i ecjes është rezultat i dëmtimit të nervit peroneal të këmbës së djathtë dhe thyerja e ashtit të pulpës deri në konsolidim të plotë të eshtrave dhe arritjen e fuqisë muskulore (që ka marrë rreth një deri dy vjet për rikuperimin e nervit peroneus).

Këto lëndime kanë shkaktuar dëmtim të pjesshëm dhe të përhershëm të funksionimi nervor të nervit peroneal.

(Arsyetimi: Ky lëndim i nervit peroneal lidhet me pakësimin e aktivitetit jetësor për një shkallë prej 20% dhe lidhet me lëvizjet e kufizuara të nyjës së shputës së djathtë).

Lëndimet kanë shkaktuar pakësim të përhershëm të kapacitetit për punë për një shkallë prej 30% të kapacitetit të përgjithshëm për punë.

(Arsyetimi: Pakësimi i kapacitetit të përgjithshëm për punë prej një shkalle prej 30% paraqet kufizim të moderuar të kapacitetit të përgjithshëm për punë pasi që konsiderohet se trupi i një personi të shëndetshëm arrin ta kompensojë këtë pakësim të kapacitetit për punë me përpjekje të shtuara trupore).

Lëndimet nuk kanë shkaktuar dëmtim të përhershëm dhe serioz të shëndetit.

(Arsyetimi: Këto lëndime nuk janë të lidhura me humbjen e ndonjë organi vital apo humbjen e ndonjë pjese apo gjymtyre trupore, humbje të përhershme të kapacitetit për punë, mbi shkallën prej 30%).

Këto lëndime nuk kanë shkaktuar dëmtim të palës së lënduar po kanë shkaktuar deformim të shkallës së mesme.

(Arsyetimi: Deformimi paraqet dëmtimin e portretit të fytyrës të palës së dëmtuar apo dëmtimin e pamjes trupore si pasojë e amputimeve të ndryshme (humbje e gjymtyrëve). Në këtë rast të veçantë, kemi të bëjmë me deformim trupor (në aspektin estetik) të shkallës mesatare që manifestohet me shenja në muskulin e pulpës së djathtë që lidhet me çalim të lehtë).

PËRFUNDIMI:

Trajtimi mjekësor i Azem Limajt të lënduar tashmë ka përfunduar. Megjithatë, trajtimi i duhur ortopedik dhe neuro-kirurgjik, lëndimet trupore të shkaktuar në ngjarjen kritike (01.01.11) lidhen me pasoja të përhershme të shëndetit, siç janë përshkruar më lart.”

83. Prandaj, edhe në mungesë të kundërshtimit përmbajtësor të këtyre gjetjeve, Trupi gjykues arrin në përfundim se lëndimet e Azem Limajt arrijnë kufirin e Lëndimit të Rëndë Trupor sipas nenit 154 paragrafi 1, nën-paragrafi 2 dhe 4 të KPPK. Në bazë të nenit 360 paragrafi 2 të KPPRK klasifikimi ligjor i akuzave të paraqitura nga Prokurori nuk janë detyruese për gjykatën.

84. Pasi që Emini është liruar nga Pika 2, Berat Krasniqi nuk do të dënohet për kryerjen e kësaj vepre në bashkë-kryerje.

PIKA 3 (Berat Krasniqi)

85. Duke shtënë në drejtim të pjesës së poshtme të trupit të Ilir Limajt të lënduar, pas së cilës plumbi e goditi dyshemenë e ndërtuar nga guri dhe u kthye rikoshet në pjesën e djathtë të shputës së tij, duke shkaktuar plagë e cila ia dëmtoi lëkurën, indet e lëkurës, ashtin talus të shputës së djathtë dhe thyerje në shumë pjesë dhe hyrje në pjesën e brendshme të shputës së djathtë, përderisa pjesë të plumbit gjithashtu lënduan pjesën e pasme të shputës së tij të majtë dhe pjesën përfundi gjurit të majtë, kanë thyer ashtin dhe kanë hyrë në palcë, Trupi gjykues vjen në përfundim se sulmi me AK47 nga Berat Krasniqi është kryer me qëllim të shkaktimit të lëndimeve të rënda trupore.

86. Sa i përket lëndimeve të Ilir Limajt, mjeku Flamur Blakaj ka marrë parasysht si në vijim:

“Lëndimet e përshkruara në gjetjet-konkluzionet paraqesin: Plagë nga armë zjarri, në rajonin e të dy nyjeve të këmbëve (art T/C). Thyerje të ashtit thallus (në shputë). Thyerje të pjesshme të fyellit të ashtit të majtë, të shkaktuara nga veprimi dinamik i pjesëve metalike (fragmenteve) të lëvozhgës së predhës së shtënë nga arma e zjarrit (disa fragmente janë nxjerrë në mënyrë kirurgjike dhe disa ende kanë mbete), që si e tillë përbën Lëndim të Rëndë Trupor, lëndime të cilat nuk kanë qenë të rrezikshme për jetë në momentin e lëndimit.

(Arsyetimi: Nuk kanë qenë të rrezikshme për jetë në momentin e lëndimit, sepse organet vitale nuk janë prekur dhe enët kryesore të gjakut nuk janë dëmtuar në aso mënyre që të çojnë drejt shokut hemorragjik).

Këto lëndime nuk kanë shkaktuar dëmtim dhe dobësim të përhershëm të funksionit të këmbëve.

(Arsyetimi: Ne jemi të bindur se lëndimi dhe dobësimi nuk është i përhershëm, për shkak se edhe pse për momentin fleksibiliteti i shputës së djathtë dhe i gishtave nuk është i kompletuar, me ndihmën e fizioterapisë ky kufizim mund të tejkalohet).

Këto lëndime kanë shkaktuar dëmtim dhe dobësim të përkohshëm të shputës së djathtë dhe të funksionit të gishtërinjve, që lidhet me pengesa në ecje (lëvizje).

(Arsyetimi: Dëmtim dhe dobësim i përkohshëm i ecjes si pasojë e thyerjes së talusit të shputës së djathtë dhe thyerje e pjesshme e tibia së majtë, deri në konsolidimin e plotë eshtëror dhe deri në arritjen e fuqisë muskulore (që ka zgjatur rreth 1 vit).

Këto lëndime nuk kanë shkaktuar dëmtim të përhershëm të ndonjë organi vital apo të ndonjë pjese vitale të trupit.

(Arsyetimi: Lëndimet e lartë-përshkruara kanë ndikuar vetëm përkohësisht në pakësimin e përgjithshëm të aktiviteteve jetësore (rreth 1 vit).

Këto lëndime nuk kanë shkaktuar zvogëlim të përhershëm të aftësisë për punë, por vetëm dëmtim të përkohshëm (rreth 1 vit).

(Arsyetimi: Për arsye se 1 vit pas ngjarjes kritike, pala e dëmtuar nuk ka qenë në gjendje të punojë).

Këto lëndime nuk kanë shkaktuar dëmtim serioz të përhershëm për shëndetin.

(Arsyetimi: Këto dëmtim nuk janë të lidhura me humbjen e ndonjë organi vital apo me humbjen e ndonjë pjese apo gjymtyrëve trupore, me pasoja të humbjes së përhershme të aftësisë për punë).

Këto lëndime nuk kanë shkaktuar shpërfytyrim të palës së dëmtuar por kanë shkaktuar deformim trupor të shkallës së ulët.

(Arsyetimi: Shpërfytyrimi paraqet deformimin e pamjes së fytyrës të palës së dëmtuar apo deformimin e pamjes trupore si pasojë e amputimeve të ndryshme (humbje të gjymtyrëve). Në rastin tonë kemi të bëjmë me deformim trupor (në aspekt estetik) të shkallës së ulët që manifestohet me shenjë plage në femurin e djathtë dhe të majtë në shputa).

PËRFUNDIMI:

Për palën e dëmtuar, Ilir Limaj, trajtimi ende nuk ka përfunduar, për shkak se në shputa ende ka pjesë të fragmentarizuara metalike, të cilat sipas rekomandimit të mjekut ortoped në të ardhmen, varësisht nga statusi klinik, mund të kalojë në një intervenim tjetër kirurgjik.

Momentalisht gjendja e tij shëndetësore është stabile dhe ne jemi të bindur se nuk do të ketë pasoja shëndetësore.”

87. Prandaj, edhe në mungesë të kundërshtimit përmbajtësor të këtyre gjetjeve, Trupi gjykues vjen në përfundim se lëndimet e Ilir Limaj arrijnë kufirin e Lëndimit të Rëndë Trupor sipas nenit 154, paragrafi 1, nën-paragrafi 4 i KPPK. Sipas nenit 360, paragrafit 2 të KPPRK, klasifikimi ligjor i akuzave i prezantuar nga prokurori nuk është detyrues për Gjykatën.

PIKA 4 (Hazir Krasniqi)

88. Trupi gjykues vjen në përfundim se Hazir i ka ndihmuar Eminin me dashje në krimin e rëndë të kryerjes së vrasjes së rëndë. Duke i siguruar veturë dhe duke e përcjellë Eminin nga vendi i krimit, ai ka dhënë përkrahje thelbësore, pa të cilën ndihmesë kryerja e krimit do të ishte ndjeshëm më e vështirë.
89. Prandaj, Trupi gjykues vjen në përfundim se kontributi i Hazirit e arrin kufirin e Nenit 25 të KPPK, dhe Haziri mund të mbahet penalisht përgjegjës.

PIKA 5 (Berat dhe Durim Krasniqi)

90. Gjatë shqyrtimit gjyqësor më 2 shkurt 2014, edhe Berati e edhe Durim Krasniqi kanë pranuar posedimin e paautorizuar të armëve përkatëse të zjarrit tipi AK 47 të kalibrit 7.62 x 39mm, me numër serik 759933, dhe armën e zjarrit tipi AK 47 të kalibrit 7.62 x 39mm, me numër serik 074949-89.
91. Pas kryerjes së krimeve, ata i fshehën këto armë në shkurre. Më 2 janar 2011, ata i dorëzuan këto armë në polici.⁵⁵ Përdorimi i armës nga Berati është dëshmuar me pranimin e tij për shkaktim me dashje të lëndimit të rëndë trupor ndaj Azem dhe Ilir Limaj.
92. Përdorimi i paautorizuar i armës së zjarrit nga Durim Krasniqi nuk përkrahet mjaftueshëm. Prandaj, Gjykata ka zbatuar nenin më të favorshëm Nenin 374, paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK).

VII. Dënimi

93. Trupi gjykues thekson se, në bazë të Nenit 64, paragrafi 1 i KPK, për përcaktimin e dënimit, ka marrë parasysh qëllimin e dënimit, nivelin e përgjegjësisë penale, motivin për të cilin është kryer vepra penale, intensitetin e rrezikut dhe dëmtimin e vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është

⁵⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 24.04.14, deklarata e Avni Krasniqit.

kryer krimi, sjelljen e mëparshme të të pandehurve, pranimin e dënimit dhe në këtë rast nuk ka pranim të fajit, rrethanat e tyre personale dhe sjelljen e tyre pas kryerjes së veprës penale.

Rrethanat lehtësuese

94. Trupi gjykues i ka marrë parasysh rrethanat në vijim në favor të të pandehurve Emin, Berat, Durim dhe Hazir Krasniqi.

95. Të pandehurit nuk kanë ndonjë të dhënë penale paraprake.

96. Përveç Beratit, të gjithë të pandehurit janë të martuar, kanë fëmijë dhe janë të vetmit sigurues të të hyrave për familjet e tyre.

97. Më tej, Durimi dhe Berat Krasniqi i kanë treguar policisë ku i kanë fshehur armët dhe janë deklaruar fajtor për veprën penale të përdorimit dhe/ose posedimit të paautorizuar të armëve.

Rrethanat rënduese

98. Në anën tjetër ekzistojnë shumë rrethana rënduese për të pandehurit.

99. Gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, të pandehurit nuk kanë shfaqur ndonjë pendesë ndaj viktimave dhe të afërmeve të mbijetuar. Vrasja e Skender Limajt i ka lënë dy fëmijë dhe të vejën e tij, Minire Limaj, duke u përpjekur të kujdeset për ta pa babain e tyre. Ndikimi i humbjes së tij në jetët e tyre, është ilustruar nga deklarata të cilën e ka dhen Minire Limaj para gjykatës.⁵⁶

100. Trupi gjykues i konsideron të pandehurit përgjegjës për veprimin kaq të dhunshëm dhe të pamëshirshëm para fëmijëve. Dy fëmijët e të ndjerit Skender Limaj janë traumatizuar dhe kanë vuajtur nga ankthet që nga rasti i vrasjes së babait të tyre para syve të tyre. Minire Limaj

⁵⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 05.02.14, deklarata e Minire Limaj.

deklaroi se kur ajo arriti në vendin e krimit, ajo i pa fëmijët e saj duke ulëritur.⁵⁷ Për më tepër, veprimet e dhunshme të kryera nga të pandehurit kanë shkaktuar situatë të rrezikshme dhe të tmerrshme për të gjithë që kanë qenë prezent në restorant.

101. Azem dhe Ilir Limaj kanë pas nevojë për trajtim të gjerë për lëndimet e tyre dhe do të vazhdojnë të kenë nevojë edhe për një kohë të gjatë në të ardhmen. Të dy nuk mund të ecin në mënyrë të duhur. Të dy ende kanë dhimbje nga lëndimet e tyre. Nuk janë vetëm lëndimet në shputat dhe këmbët e tyre por edhe trauma psikologjike, e cila e shqetëson jetën e tyre që nga kjo ngjarje. Kjo vlen jo vetëm për palët e dëmtuara por për të gjithë dëshmitarët okularë.
102. Në mënyrë më specifike, Trupi gjykues e ngarkon në dëm të të pandehurve Emin, Berat dhe Durim që nuk janë dorëzuar në polici të njëjtën natë apo mëngjesin e nesërm, edhe pasi që zyrtari policor dhe kushëriri Avni Krasniqi e ka pyetur vëllain e Beratit se ku janë. Familja e ka ditur që nga mbrëmja e 2 janarit 2011 se diçka e jashtëzakonshme ka ndodhur. Ata janë mbledhur pas ngjarjes dhe e kanë diskutuar. Vetëm pasi që Gani Krasniqi i ka urdhëruar të dorëzohen më 2 janar 2011, ata u dorëzuan kur arriti policia.
103. Sa i përket veprave penale të posedimit të paautorizuar të armëve, Trupi gjykues konsideron se rreziku i kësaj vepre penale ndaj shoqërisë është jashtëzakonisht i lartë. Siç tregojnë edhe rastet tjera penale në rajon dhe në tërë Kosovën, ekziston një tendencë e pafat në këtë shoqëri që problemet të zgjidhen me armë të cilat janë shumë të lehta për tu gjendur. Fakti se këto armë janë suvenire nga lufta dhe/apo përfaqësojnë kujtime të të afërmeve të cilët kanë luftuar në luftë nuk e zvogëlon seriozitetin e rrezikut të cilin e sjellin.
104. Duke u bazuar në ato që u thanë më lart dhe më poshtë, Trupi gjykues vendos se të pandehurit do të dënohen me dënime si në vijim:

Emin Krasniqi

⁵⁷ Ibid.

105. Shkelja e Nenit 147 të KPPK dënohet me burgim nga së paku 10 vite apo burgim afat-gjatë, që nënkupton 21-40 vite. Nëse Gjykata shpall një dënim me burgim afat-gjatë për një veprë penale ajo do ta shqiptojë vetëm këtë dënim.
106. Gjatë shqiptimit të sanksionit penal, gjykata duhet t'i ketë parasysh të dyja – edhe qëllimin e përgjithshëm të dënimit – që është të ndalohen aktivitetet e rrezikshme për shoqërinë duke i ndaluar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme penale dhe qëllimi specifik, të parandalohet kryesi nga kryerja e sërishme e veprave penale.
107. Në këtë rast, kjo është vrasja e parë për të cilën dënohet Emimi, por në anën tjetër vetëm dënimi me burgim afat-gjatë është i përshtatshëm për shkak të rëndesës së veprës penale, dhe rrethanave në të cilat është kryer vepra, siç janë theksuar më lart.
108. Duke i marrë parasysh të gjitha elementet e theksuar më lart, gjykata vjen në përfundim se dënimi me njëzet e dy (22) vjet të burgimit afat-gjatë nuk është në disproporcion dhe reflekton dënim të përshtatshëm për këtë autor të krimit dhe për këtë krim.

Durim Krasniqi

109. Shkelja e Nenit 374, paragrafi 1 i KPK, i lidhur me Nenin 38 dhe 73 të KPPK, është i dënueshëm me gjobë deri në 7500 euro ose 5 vjet burgim. Trupi gjykues konsideron se rrethanat e theksuara më lart dhe fakti rëndues se Durimi e ka pas këtë armë pa autorizim për një kohë të gjatë që nga përfundimi i luftës, një afat prej një (1) vit burgim është i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm për ta përmbushur qëllimin e dënimit dhe për të sjell drejtësi ndaj veprës.

Berat Krasniqi

110. Shkela e Nenit 154 të KPK është e dënueshme me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet. Shkelja e Nenit 328 të KPPK, është e dënueshme me gjobë deri në 7500 euro ose 8 vjet burgim.

111. Në bazë të Nenit 71 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nën-paragrafi 2 i KPPK, Trupi gjykues do t'i unifikojë dënimet të cilat do t'i merr Berat Krasniqi për secilën veprë penale. Dënimi unik duhet të jetë më i lartë se secili dënim individual, por jo aq i lartë sa shuma e dënimeve të shqiptuara.
112. Duke marrë parasysh rëndesën e lëndimeve të viktimave, Trupi gjykues vjen në përfundim se për sulmin ndaj Azem Limajt, i pandehuri duhet të dënohet me burgim me kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 10 (dhjetë) muaj, dhe për sulmin ndaj Ilir Limaj, ai duhet të marrë dënim prej 3 (tre) vjet e 9 (nëntë) muaj burgim.
113. Më tej, ngjashëm me dënimin e Durim Krasniqit, Trupi gjykues do ta dënojë Berat Krasniqin me burgim për kohëzgjatje prej 1 (një) viti për pronësi të paautorizuar të armëve.
114. Sipas Nenit 71 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nën-paragrafi 2 i KPPK, Trupi gjykues vjen në përfundim se i pandehuri Berat Krasniqi dënohet me një dënim unik që përbëhet nga një afat burimi në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vitesh.

Hazir Krasniqi

115. Shkelja e Nenit 147, i lidhur me Nenin 25, të KPPK është e dënueshme deri në tre të katërtat e dënimit maksimal të parashkruar për veprën penale të vrasjes së rëndë.
116. Siç është shpjeguar më lart, Trupi gjykues vjen në përfundim se Haziri ka luajtur rol kritik në kryerjen e krimeve. Ai jo vetëm që ka siguruar ndihmë thelbësore, por ka luajtur rol në atë që ka çuar drejt ngjarjeve dhe motivit të veprave të cilat patën rezultat dramatik përfundimtar ku një person humbi jetën. Së bashku me të gjitha elementet e theksuara më lart, Trupi gjykues vjen në përfundim se Hazir Krasniqi duhet të dënohet me burgim prej 5 (pesë) vitesh.

VIII. Gjërë Përfundimtare të Marra Parasysh

117. Trupi gjykues vjen në përfundim se në bazë të asaj që u theksua në këtë aktgjykim, i ka plotësuar mjaftueshëm udhëzimet e dhëna nga Gjykata e Apelit në vendimin e vetë të datës 14 tetor 2013.
118. Trupi gjykues nuk sheh ndonjë domosdoshmëri për ta shpallur këtë aktgjykim në shtyp siç është theksuar në Nenin 391, paragrafi 1.6 i KPPPK.
119. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata Themelore e Prizrenit vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

P. nr. 372/13

Datës 21 prill 2016

Procesmbajtësi

Kryetari i trupit gjykues

Venera Hadri-Mollakuqe

Piotr Bojarczuk

MJETI JURIDIK:

Palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë ndaj aktgjykimit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur një kopje e aktgjykimit i dorëzohet Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore të Prizrenit në bazë të Nenit 398, paragrafi 1 i KPPPK.

